

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kuvend/ Pagat e magjistratëve, PS miraton rritjen sa 2% e pagës së Presidentit! Rama: Ligj i ri, jemi në konsultime me KiE! PD voton kundër: Puç kushtetues
ADRESA	https://tpz.al/kuvend-pagat-e-magjistrateve-ps-miraton-rritjen-sa-2-e-pages-se-president-it-rama-ligj-i-ri-per-piramiden-e-pagave-jemi-ne-konsultime-me-kie-pd-voton-kunder-puc-kushtetues-i333216
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 07:21:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 07:07:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b5d7637b909be2499936f523d2f5e1241789e0060259dcbe6c862e2f3c9add66
TEKSTI	20c2bf18d27d6424f55b8e5bc820496a91ecf078d95384efc569ac25bfe88ca2
PAMJA	01d6759f88c8474fc4c85b14262f13cd00e49de28c716877b99e0fc0b0f663ee

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	71a501793c0ccf4464e700b99d1a1ac0256e21d0c8e1efa150067344925bb0dc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	401dcdf3311c18d7b93cbabfd522e0d009d4ac62bab22fd89058a16395500d64
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/71a501793c0ccf4464e700b99d1a1ac0256e21d0c8e1efa150067344925bb0dc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

09:15 Detaje/ Plagosja e dy vëllezërve në Sarandë, vëllai i njërit prej të arrestuarve u përfshi në një sherr para tre javësh! • 09:07 Kuvend/ Pagat e magjistratëve, PS miraton rritjen r

AKTUALITET, 18 SEPTEMBER 2026, 09:07

Kuvend/ Pagat e magjistratëve, PS miraton rritjen sa 2% e pagës së Presidentit! Rama: Ligj i ri, jemi në konsultime me KiE! PD voton kundër. Puç kushtetues

tpz.al TPZ



Me 84 votat pro të mazhorancës, Kuvendi miratoi formulën e re për pagat e magjistratëve. Votimi nuk i dha fund përplasjes mes qeverisë dhe institucioneve të drejtësisë. Magjistratët e kanë kundërshtuar projektligjin e socialistëve, i cili parashikon një rritje të pagës referuese me rreth 8,500 lekë sa 2% e pagës së Presidentit, ndërkohë që kërkesa e tyre, e miratuar edhe nga KLGJ dhe KLP, është rreth nëntë herë më e lartë, afro 80 mijë lekë.

Vetë kryeministri Edi Rama ngriti kartonin jeshil në sallë, ndërsa Sali Berisha mungoi në momentin e votimit. 24 deputetë të tij votuan kundër pr. ligjit duke e cilësuar "puç kushtetues", ndërsa i vetmi që abstenuoi ishte deputeti Bujar Leskaj.

Për t'i dhënë fund kësaj situatë, qeveria ka nisur punën për hartimin e një ligji të ri për ribalancimin e piramidës së pagave. Sipas Ramës, me reformën në drejtësi, pagat e magjistratëve u rritën në mënyrë "stratosferike", duke prishur raportin me pagat e tjera. Ai e cilësoi "lajthitje" kërkesën që pagat e magjistratëve të rriten automatikisht sa herë rriten pagat e punonjësve të tjerë.

"Këtu është nevoja për të bërë një ligj të ri, për t'i dhënë fund kësaj historie, e cila e ka zanafillën e vet në atë moment kur, në bërjen e reformës, nuk u përcaktua koha se kur piramida do të balancohej. Nuk u tha qartë dhe nuk u tha troç që ju do të merrni këtë tani nga taksat e shqiptarëve, shumë më tepër se gjithë të tjerët, sepse reforma kërkon nga ju që të bëni një sforc, por ama kjo nuk do të jetë një rritje permanente. Sa herë të rriten të tjerët, do të rriteni edhe ju, sepse i bie pastaj, siç e thashë në fillim, do të krijonim shtetin e parë në botë. Dhe unë i sfidoj të gjithë të më sjellin, të paktën në 2 mijë vjetët e fundit, një sistem ku gjykatësit kanë qenë mbi të gjithë në aspektin e taksave. Nuk ndodh. Është nonsens", tha Rama.

Kryeministri bëri të ditur se nën ligjin e ri kanë nisur kontaktet me Këshillin e Europës dhe

ide!

Vendimi i Hagës si moment reflektimi
Nga Ergys Mërtiri

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

Teje e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

"Ne kemi filluar kontaktet me Këshillin e Europës, me atë Komisionin Europian për Eficiencën e Drejtësisë. Dhe unë i kam pritur të gjithë këta që i kishit ju në komisionin përkatës, sepse kërkuam takim dhe ne e organizuam takimin. E organizuam takimin sipas dëshirës dhe kushteve të tyre, në kuptimin për t'u dhënë të gjithë mundësinë që të flasin, të flasim dhe për t'u thënë që këtu ka një problem, të cilin do ta adresojmë së bashku. Ne nuk mund të shkojmë në një konflikt pushtetesh dhe ne jemi të gatshëm, jo të gatshëm, por jemi tërësisht të angazhuar që të bëjmë një ligj të ri. Ka një sërë mënyrash për ta bërë, por kjo historia që sa herë rritet një pagë në Republikë, duhet rritur një pagë atje, duhet të marrë fund. Kjo është absurde", tha Rama. Rama i tregoi "vijat e kuqe" Gjykatës Kushtetuese, së cilës i tha ka të drejtë të rrëzojë një ligj që shkel Kushtetutën, por jo t'i diktojë Kuvendit formulën që duhet të votojë.

"Gjykata Kushtetuese është arbitri. Ajo mund ta ndalojë lojën, mund të konstatojë shkeljen, mund ta anulojë golin, por nuk mund ta marrë topin dhe të thotë: 'Topi është imi. Penalltinë do ta gjuaj unë', tha Rama.

Në shënjestër të Ramës u vunë edhe shoqatat e gjyqtarëve dhe trupa gjyqësore. Kryeministri foli për lëvizje të koordinuara mes tyre, të cilat i cilësoi shqetësuese duke thënë se dëmtojnë Republikën.

të thuash që në atë datë lindi befasi një pushtet tjetër, i cili përcaktoi atë që në fakt mund ta përcaktojë vetëm ligji, dhe nga ana tjetër të shohësh një ndërveprim shoqatash me trupën gjyqësore të Shqipërisë, të shohësh lëvizje të koordinuara, të shohësh këtë organizim është jashtëzakonisht shqetësuese. Të gjitha zhvillimet në këtë drejtim janë zhvillime që e dëmtojnë Republikën e Shqipërisë, nuk janë zhvillime që e ndihmojnë". vijoi Rama.

Por për opozitën, formula e socialistëve nuk respekton vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

"Gjykata Kushtetuese i dha Kuvendit katër muaj kohë që ta zgjidhte çështjen përpara se vendimi i saj për shfuqizimin e ligjit të pagave të hynte në fuqi. Pra, u tregua tërësisht e përgjegjshme, ndryshe nga ty dhe nga ky Kuvend që u tregua tërësisht i papërgjegjshëm". tha Bardhi.

Kriza e pagave në sistemin e drejtësisë kulmoi pasi Kuvendi nuk miratoi deri më 31 korrik formulën e re të pagave, siç kishte kërkuar Gjykata Kushtetuese. Pas kalimit të afatit, KLGJ dhe KLP vendosën që nga 1 gushti paga referuese të llogaritej mbi 222 mijë e 425 lekë, plus 14 mijë lekë shtesë për kualifikimin. Ministria e Financave nuk i ekzekutoi listëpagesat me këtë përlllogaritje, duke argumentuar se përcaktimi i pagave është kompetencë e Kuvendit.



[Për pagat e magjistratëve, t'u
sfidoni Kushtetutën, vota jonë
do të jetë kundër](#)

AKTUALITET / 17 September 2026, 22:10

[Rama shkon në Kuvend, pritjet
të votohet drafti për pagat e
gjyqtarëve](#)

AKTUALITET / 17 September 2026, 21:05

[Lukasi 3 javësh po lufton për
jetën në intubim, familja nga
Shkodra kërkon ndihmën e
shqiptarëve për ta kuruar
jashtë vendit](#)

AKTUALITET / 17 September 2026, 20:00

["Me çfarë mrrrokulle do të
hyjnë në sistem?" / Ironia e
Korreshit në Kuvend: Flisni
për IA kur ambulancat s'kanë
drita](#)

AKTUALITET / 17 September 2026, 19:23

[I shpërndar nga diali i tii Greg](#)

[Kryesia për vaksinat e miniorëve.
Të sëmurët nuk duan t'ju
takojnë ju, duan që të mos i
vidhni ilaçet](#)

AKTUALITET / 17 September 2026, 21:49

[Protestuesit rrethojnë
Komisariatit Nr. 1: Arrestoni
Edi Ramën, lironi qytetarët!](#)

AKTUALITET / 17 September 2026, 20:43

[Tabaku nga Kuvendi: 34
milionë euro për KAYO-n,
ndërsa shqiptarët mezi
paguajnë faturat, ky sistem
duhet rrëzuar](#)

AKTUALITET / 17 September 2026, 19:49

["Në 730 komente kërkohej
pushkatimi ose..." / U përplas
me protestuesit, Iris Luarasi:
Më ngjanin me pionerët e
Enverit!](#)

AKTUALITET / 17 September 2026, 19:08

[Ndërci me pagat e qytetarëve](#)

Rama viziton Malin Athos në
Greqi, qëndron gjatë natës në
Manastirin e Vatopedisë

dhe prokurorëve, SPAK nis
hetimet dhe sekuestron
praktikat te Financat

AKTUALITET / 17 September 2026, 18:59

Sfidë me transportin në Lezhë!
45 nxënës e mësues
detyrohen të udhëtojnë në një
mikorbus me 20 vende

AKTUALITET / 17 September 2026, 18:15

"Kuvendi të njohë gjenocidin
serb në Kosovë"/ Balla
përplasjet me Redi Muçin: Je
kalama! E ke ndarë mandatin
përgjysmë me Qorin, fjalimet
t'i shkruan ai

AKTUALITET / 17 September 2026, 17:54

Blushi: Interesi kombëtar në
pazar, mielli i kontaminuar
serb përmyt Shqipërinë

AKTUALITET / 17 September 2026, 17:46

Përplasjet te Kuvendi,
shoqërohen nga policia 25
protestues

AKTUALITET / 17 September 2026, 17:43

Pagat e gjyqtarëve, Shoqata
Evropiane e Magjistratëve: Po
cenohet shteti i së drejtës, të
mos anashkalohet vendimi i
Kushtetueses

AKTUALITET / 17 September 2026, 17:21

Bypass-i i Elbasanit/
Karakaçi: Projekti kushton
240 mln euro, një pjesë e
financimit do të mbulohet nga
buxheti i shtetit

AKTUALITET / 17 September 2026, 17:03

AKTUALITET / 17 September 2026, 16:32

Zhupa: Kuvendi, institucioni
që reflekton vetëm dëshirat e
Ramës

Fermerët pa asnjë mbështetje,
gjithnjë e më pak drithëra të
prodhuara në vend

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.